

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA - VLADA / GOVERNMENT
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY AND INNOVATION

Nr. Nr. 01-305 DALJE
Data Datum 26.01.2026
Nr. Njësi Njësi 6
Postimi Postimi Postimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation*

**Kabineti i Ministres në Detyrë/Kabinet Ministarke u Vršnju Dužnosti /Cabinet of the Acting
Minister**

Numër: 01-215
Data: 26.01.2026

Në mbështetje të nenit 8, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura; nenit 53, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative; nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 12, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës; nenit 77 paragrafi 3 dhe nenit 94, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenit 9, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik; nenit 4, 5, 14, 16, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe nenit 25, paragrafi 1, 4 dhe 6 të Ligjit Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore; nenit 67, paragrafi 1, nënparagrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës; nenit 1, paragrafi 2 dhe nenit 7, paragrafi 8 të Ligjit Nr. 03/L-190 për Gazetën Zyrtare; nenit 27, paragrafi 1, 3 dhe 7 dhe nenit 28, paragrafi 2 të Statutit të Institutit Albanologjik të Prishtinës; si dhe nenit 12, paragrafi 6 dhe 9 të Rregullores së Punës Nr. IAP 90/2 të Këshillit Shkencor të Institutit Albanologjik të Prishtinës, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Informacionit, nxjerr:

V E N D I M

1. Anullohet vendimi me Nr. IAP/127, i datës 04.12.2025, për zgjedhjen e Drejtorit të Institutit Albanologjik të Kosovës. Obligohet Këshilli Drejtues që pa e kaluar afatin ligjor prej dy (2) vitesh nga koha që Instituti nuk ka zgjedhur drejtor, duke përjashtuar kohën nga

zgjedhja e drejtorit deri në anulimin e konkursit, mandatin e drejtorit t'ia kalojë Ushtruesit të Detyrës nga radhët e punonjësve të Institutit, të njoftojë Ministrinë për shpalljen e konkursit të ri për Drejtor të Institutit, si dhe të marrë parasysh edhe rekomandimet e Ministrisë lidhur me kushtet dhe kriteret e konkursit për ndërkombëtarizimin e shkencës.

2. Obligohet Këshilli Drejtues i Institutit Albanologjik të Prishtinës që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për harmonizimin e Rregullores së Punës Nr. IAP 90/2 të Këshillit Shkencor, të nxjerrë më 01.10.2025, me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Statutin e Institutit dhe me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik. Pas harmonizimit, Këshilli Drejtues obligohet të sigurojë publikimin e Rregullores në përputhje me nenin 16, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, si dhe procedimin për publikim sipas Ligjit Nr. 03/L-190 për Gazetën Zyrtare, neni 1, paragrafi 2 dhe neni 7, paragrafi 8.
3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Anulohet vendimi Nr. IAP/127, datë 4.12.2025, për zgjedhjen e Drejtorit të Institutit Albanologjik të Prishtinës (IAP), për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore gjatë zhvillimit të procedurës.

Në bazë të nenit 25, paragrafi 6, të Ligjit Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, MASHTI ka të drejtë të rishikojë ose të anulojë vendimin e Këshillit Drejtues (KD), kur konstatohet se janë shkelur dispozitat ligjore që rregullojnë emërimin apo shkarkimin e drejtorit të institutit.

Për rrjedhojë, evidentohen, ndër të tjera, shkeljet në vijim:

- **Konkursi publik i datës 14.10.2025 për zgjedhjen e Drejtorit të Institutit, nuk ka respektuar rekomandimet e dhëna nga MASHTI më 10.04.2025 lidhur me kushtet dhe kriteret e konkursit.**

Gjatë mandatit të tretë të Ushtruesit të Detyrës të IAP-së, z. Naïm Berisha, MASHTI, në bashkëpunim me Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, i ka ofruar mbështetje IAP-së për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e Drejtorit, duke i përcjellë rekomandime konkrete lidhur me kushtet dhe kriteret e konkursit në përputhje me legjislacionin që rregullon punën e Institutit, si dhe me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik. Megjithatë, këto rekomandime nuk janë përfillur as brenda këtij afati, as gjatë konkursit publik të datës 14.10.2025.

Sipas Ligjit Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, konkretisht nenet 4, 5 dhe 14 të tij, institucionet kërkimore-shkencore janë të obliguara të promovojnë bashkëpunimin kërkimor me universitete dhe institucione relevante brenda dhe jashtë vendit, të fuqizojnë bashkëpunimin ndërkombëtar, me theks të veçantë atë evropian, si dhe të ndërmarrin masa për integrimin në Hapësirën Evropiane të Kërkimit Shkencor (ERA). Për më tepër, Programi Kombëtar i Shkencës 2023–2028 e identifikon ndërkombëtarizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore si një objektiv strategjik. Në këtë kuadër, IAP ka qenë i obliguar t'i përfshijë rekomandimet e MASHTI-t, të cilat parashihnin kushte dhe kriterë shtesë në konkursin për Drejtor, me qëllim të ngritjes së standardit shkencor dhe të ndërkombëtarizimit të Institutit.

- **Asnjë nga anëtarët e KSh-së nuk është caktuar në Komisionin për vlerësimin e aplikantëve për pozitën e drejtorit të IAP-së.**

Në bazë të vendimit të datës 20.11.2025 të Këshillit Shkencor (KSh) për caktimin e anëtarëve të Komisionit për vlerësimin e aplikantëve për pozitën e drejtorit, KSh nuk ka caktuar asnjë nga anëtarët e KSh-së.

Nenit 27, paragrafi 3, i Statutit të IAP-së parashikon se: *Komisioni përbëhet prej pesë anëtarëve të cilët i cakton Këshilli Shkencor nga radha e punonjësve shkencorë të Institutit. Anëtarë të Komisionit mund të caktohen edhe punonjës nga institucione të tjera të shkencës.*

Pjesa e parë e këtij paragrafi përcakton përbërjen bazë dhe obligative të Komisionit për vlerësimin e aplikantëve për përzgjedhjen e Drejtorit, e cila duhet të përbëhet nga anëtarë të caktuar nga radhët e punonjësve shkencorë të Institutit. Ndërkaq, pjesa e dytë e këtij paragrafi, e cila parashikon se anëtarë të Komisionit mund të caktohen edhe punonjës nga institucione të tjera të shkencës, nuk përjashton përfshirjen e anëtarëve të KSh-së nga radhët e punonjësve shkencorë të Institutit, pasi që kjo dispozitë, parimisht, ka karakter dytësor dhe opsional në raport me përbërjen e rregullt të Komisionit për vlerësimin e aplikantëve për pozitën e Drejtorit.

Sidoqoftë, që nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, KSh nuk ka mundur të caktoj asnjë anëtarë të jashtëm në Komision të vlerësimit për shkak se neni 77, paragrafi 3, i këtij ligji, ka shfryqizuar të gjitha dispozitat për procedurën e rekrutimit të nënpunësve të shërbimit publik të cilat bien në kundërshtim me të, duke përfshirë këtu edhe pjesën e paragrafit 3 të Statutit të IAP-së e cila parashihet mundësinë për caktimin e anëtarëve të jashtëm krahas anëtarëve të KSh-së.

Duke u bazuar në sa e më sipër, për MASHTI-n, mbetet e paqartë arsyeja e KSh-së për caktimin e një Komisioni vlerësues me përbërje tërësisht të jashtme, kur sipas dispozitave të lartëcekura Komisioni parimisht do të duhej të ishte i brendshëm, e duke pasur parasysh

që Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ka përparësi në relacion me dispozitat që bien në kundërshtim me procedurën e rekrutimit të nënpunësve të shërbimit publik, tërësisht të brendshme. Për më tepër, kur KSh përbëhet nga 31 anëtarë, së paku disa nga këta anëtarë do të duhej të kishin dhënë pëlqimin e tyre për të u bërë pjesë e këtij Komisioni e jo të përjashtoheshin tërësisht.

- **Përbërja e Komisionit për vlerësimin e aplikantëve për pozitën e drejtorit të IAP-së është e paligjshme.**

Në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, konkretisht me nenin 67, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës dhe nenin 94, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, KSh, me vendimin e datës 20.11.2025, për caktimin e anëtarëve të Komisionit për vlerësimin e aplikantëve për pozitën e drejtorit, ka caktuar edhe persona të pensionuar.

Në mbështetje të dispozitave të mësipërme, të punësuarit i ndërpritet kontrata e punës pas mbushjes së moshës 65 vjeç, dhe kufizimet për moshën e pensionimit nuk vlejnë vetëm për zyrtarët e kabineteve. Në përputhje me këtë, KSh, në Komisionin e Vlerësimit, përveç që nuk ka pasur të drejtë të caktojë anëtarë të jashtëm, nuk ka pasur të drejtë të caktojë as persona të pensionuar, pasi kur një person arrin moshën e pensionimit, marrëdhënia e rregullt kontraktuale përfundon.

- **Pas vlerësimit të Komisionit lidhur me zbatimin e procedurës për vlerësimin e Drejtorit, KSh nuk ka pasur të drejtë të votojë për “zgjedhje” të Drejtorit.**

KSh, në mbledhjen e datës 27.11.2025 duke u thirrur në Rregulloren e Punës Nr. IAP 90/2 të Këshillit Shkencor, pas përfundimit të shqyrtimit të vlerësimit të kandidatëve nga Komisionit i caktuar për këtë qëllim, ka organizuar një proces jo ligjor votimi. Në këtë kontekst, MASHTI ka konstatuar se dispozitat e Rregullores së Punës Nr. IAP 90/2, të cilat parashohin një proces të tillë, ndonëse të miratuara nga KD-ja, bien ndesh me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Ligjin Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore dhe Statutin e IAP-së.

Në aspektin e procedurës së përzgjedhjes së drejtorit, Ligji Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, neni 25, paragrafi 4, dhe Statuti i IAP-së, neni 24, paragrafi 2.2, përcaktojnë se KSh-ja i propozon KD-së kandidatët për drejtor, mbi bazën e vlerësimit shkencor dhe profesional të Komisionit për vlerësimin e kandidatëve për secilin kandidat. Në këtë kuadër, kompetenca e KSh-së kufizohet në propozimin e kandidatëve dhe monitorimin e procesit të vlerësimit pa përfshirë të drejtën për të vendosur procedura shtesë apo për të zgjedhur ose votuar kandidatët.

Neni 12, paragrafi 6, i Rregullores në fjalë përcakton se: *Çdo anëtar i Këshillit Shkencor ka të drejtë të rrumbullakosë vetëm një kandidat në fletëvotim.* Ndërkaq, neni 12, paragrafi 9 përcakton: *Në bazë të rezultateve të votimit, Këshilli Shkencor i propozon Këshillit Drejtues kandidatët për drejtor të Institutit.*

Këto dispozita, të lexuara së bashku, e orientojnë procedurën drejt një preference të vetme dhe rrezikojnë ta reduktojnë propozimin në një nominim të vetëm, duke e ngushtuar kuptimin dhe zbatimin e formulimit *kandidatët* të paraparë në Ligjin Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore dhe Statutin e IAP- së dhe, si pasojë, cenojnë ushtrimin e kompetencës së KD-së për zgjedhjen e drejtorit.

Në rastin konkret, në mbledhjen e datës 27.11.2025, kur në KSh është votuar me 15 vota për një kandidat dhe 0 vota për dy kandidatët e tjerë, cila është arsyeja e KSh-së për t'ia propozuar KD-së "kandidatët" për zgjedhjen e Drejtorit, kur ky "vendim" veçse është marrë në KSh?

Në bazë të sa e më sipër, MASHTI vlerëson se një proces i tillë i votimit prodhon efekt kufizues de facto në ushtrimin e kompetencës së KD-së për shkak se KD-ja është vënë në pozitë që vendimmarrja të perceptohet si e paracaktuar dhe më shumë si ratifikim i rezultatit të votimit, sesa si zgjedhje reale ndërmjet alternativave.

- **Procedura për 'zgjedhjen' e Drejtorit është mbështetur në Rregulloren e Punës Nr. IAP 90/2 të KSh-së, e cila, në kohën kur është zhvilluar procedura, nuk përbënte akt juridik me fuqi të plotë ligjore.**

Sipas legjislacionit në fuqi, aktet që rregullojnë organizimin e brendshëm dhe procedurat e veprimtari institucionale duhet të jenë të publikuara dhe të qasshme, me qëllim të transparencës, sigurisë juridike dhe kontrollueshmërisë së veprimeve të institucionit.

MASHTI vlerëson se, duke qenë se Rregullorja e Punës Nr. IAP 90/2 nuk ka qenë e publikuar në përputhje me kërkesat ligjore (është publikuar me datën 20.01.2026), lind paqartësi thelbësore lidhur me zbatueshmërinë dhe efektet juridike të dispozitave të saj në relacion me procedurën e 'zgjedhjes' së Drejtorit dhe proceset e tjera ku ajo është përdorur si bazë procedurale.

Po ashtu, në kuptim të Ligjit Nr. 03/L-190 për Gazetën Zyrtare, institucionet janë të obliguara që aktet juridike t'i procedojnë për publikim brenda afateve të përcaktuara ligjore, ndërsa Gazeta Zyrtare përbën publikimin e vetëm zyrtar për aktet e institucioneve të Republikës së Kosovës.

Për pasojë, mbështetja në një akt që nuk rezulton i publikuar dhe i proceduar për publikim sipas kërkesave ligjore cenon parimin e ligjshmërisë dhe sigurisë juridike dhe ndikon në vlefshmërinë e veprimeve dhe vendimeve të ndërmarra në këtë proces.

Vendimi i dorëzohet:

1. Institutit Albanologjik të Prishtinës;
2. Kabinetit të Ministres/MAShTI;
3. Zyrës së Sekretarit të përgjithshëm/MAShTI;
4. Arkivit /MAShTI.

Arbërie Nagavci

Ministre në detyrë/MAShTI

